VENDIM
Nr.1450, datë 5.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.901, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, NËPUNËSVE TË KABINETEVE DHE PUNONJËSVE MBËSHTETËS, NË ADMINISTRATËN E DISA INSTITUCIONEVE TË PAVARURA",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja "d" e pikës 1 të vendimit nr.901, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"d) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2008, të përballohen nga fondet e miratuara, për këtë vit, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha